



**STATUT I SHOQERISE  
"LetAll" Sh.P.K.**

Sot, me 15/05/2023 personat e meposhtem:

1. **ZNJ.ZSUZSANNA NAGY**, atesia Pal, shtetase Hungareze, lindur në KAPOSVAR (MAGYARORSZAG) dhe banuese në HUNGARI, me adresë Hungari, lindur më 07/04/1960, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjofitim ID Hungareze me nr. 677559BE.
2. **ZNJ.ZSUZSANNA MAHR**, atesia Erno, shtetase Hungareze, lindur në BUDAPEST 08 (MAGYARORSZAG) dhe banuese në HUNGARI, me adresë Hungari, lindur më 09/08/1958, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjofitim ID Hungareze me nr. 175156JE.

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, ka miratuar kete Statut si vijon:

**KAPITULLI I  
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA**

**Neni 1**

**Themelimi, Emri dhe Forma**

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte "LetAll" Sh.P.K.  
 Shoqeria "LetAll" Sh.P.K. eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (me pas referuar si "Ligji Tregtar") ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).  
 Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Regjistrimit (me pas referuar si "QKR") ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.  
 Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.  
 Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

**Neni 2**

**Selia**

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: Selia e Shoqerise eshte: Durrës, Rruga "Plazh/ 13. Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**

**Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqerisë do të përfshijë sa vijon:

- Konsulence Biznesi:
- Sherbime Turistike:
- Trajnime te ndryshme."

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqerisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.



A2023051400187921389

Objekti i aktivitetit te Shoqërisë mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

#### Neni 4

##### Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë deri ne Dhjetor 2073. Shoqëria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## KAPITULLI II

### KAPITALI – KUOTAT

#### Neni 5

##### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Lek (dhjete mijë leke). Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota qe jane paguar e zoterohen teresisht nga ortakët themelues si vijon:

- Ortakja themeluese **ZNJ.ZSUZSANNA NAGY**, atesia Pal, shtetase Hungareze, lindur në KAPOSVAR (MAGYARORSZAG) dhe banuese në HUNGARI, me adresë Hungari, lindur më 07/04/1960, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Hungareze me nr. 677559BE, zotëruese e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 5.000 Lek (pese mijë leke) që përbën 50 % (pesedhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Ortakja themeluese **ZNJ.ZSUZSANNA MAHR**, atesia Erno, shtetase Hungareze, lindur në BUDAPEST 08 (MAGYARORSZAG) dhe banuese në HUNGARI, me adresë Hungari, lindur më 09/08/1958, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Hungareze me nr. 175156JE, zotëruese e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 5.000 Lek (pese mijë leke) që përbën 50 % (pesedhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku eshte pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqëria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

#### Neni 6

##### Kuotat

##### Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqërisë nen pergjegjesine e Administratoreve (“**Regjistri i Ortakeve**”).

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

#### Neni 7

##### Transferimi i Kuotave

7.1. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjithë apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.

7.2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t’u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.



A2023051400187921389

- 7.3. Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.4. Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
- 7.5. Administratoret brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.6. Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejta e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.7. Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak si me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuoten e tij do te jete i lire t'ia transferoje kete kuote personit/ave te percaktuar prej tij.
- 7.8. Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtuar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuoten objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit 1 (nje) mujor te percaktuar me siper.
- 7.9. Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

#### Neni 8

##### Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejta e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete. Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

#### Neni 9

##### Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

### KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE

#### Neni 10

##### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;



A2023051400187921389

- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katermbedhete) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

#### Neni 11

#### Organi Administrues / Administratoret

Organi Administrues perbehet nga 2 (dy) Administratore qe emerohen e shkarkohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.



A2023051400187921389

Personi i mëposhtëm caktohen si Administratore të shoqërisë me mandat 5 vjeçar, të cilat nënshkruajnë veç e veç:

- **Znj.Zsuzsanna Nagy dhe Znj.Zsuzsanna Mahr.**

Administratori përfaqëson Shoqërinë sipas parashikimeve të Statutit.

Administratori do të:

- (i) administrojë veprimtarinë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- (ii) përfaqësojë Shoqërinë;
- (iii) kujdeset për mbajtjen e rregullt të librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures se veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- (v) krijojë një sistem njoftimi të pershtatshëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- (vi) kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
- (vii) raportojë përpara Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe për perfundimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për performancën e Shoqërisë;
- (viii) kryejë detyra të tjera, të percaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese së Ortakëve sa herë që kërkohet sipas Ligjit apo këtij Statuti.

Administratori mund të autorizojë persona të tjerë për të vepruar në emri dhe për llogarinë e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorinë e akteve dhe veprimeve që përfaqësojë mund të kryejë.

Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime të kompetencave të administrimit.

#### Neni 12

##### Kontrolli i Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të emerojë një ose disa eksperte kontabel të autorizuar për kontrollin e llogarive të Shoqërisë.

#### KAPITULLI IV

##### VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

#### Neni 13

##### Viti Financiar

Viti financiar ka një kohezgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

Në mënyrë përjashtimore, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### Neni 14

##### Rezerva Ligjore

Shoqëria do të kalojë në fondin rezerve të detyrueshëm të paktën 5% (pese për qind) të fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve të arrijë vlerën e barabartë me 10 për qind të kapitalit themeltar.

#### Neni 15

##### Dividendet

Pas miratimit të bilancit vjetor dhe percaktimit të shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve percakton shumën e fitimeve që do të shpërndahet secilit prej Ortakëve si dividend, në përjestim me pjesën përkatëse në kapitalin themeltar.

#### KAPITULLI V

##### PRISHJA - LIKUIDIMI

#### Neni 16



A2023051400187921389

### Prishja e Shoqerise

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

### Neni 17

#### Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

### Neni 18

#### Dispozita Perfundimtare

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesisie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

*Për ndjekjen e të gjithë procedurave në lidhje me regjistrimin fillestar të Shoqërisë dhe akteve përkatëse në Regjistrin Tregtar (QKB) Z. Rafael Lajos Visy, mund të paraqitet e veprjë veçmas apo së bashku me të drejta e kompetenca të plota për nënshkrimin dhe dorëzimin e çdo aplikimi, kërkesë dhe/ose dokumenti që konsiderohet se duhet paraqitur pranë Regjistrin Tregtar për kompletimin e regjistrimit.*

Ky Statut nenshkruset rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhete Shqipe.

### ORTAKET THEMELUES

MAHR ZSUZSANNA

Mahr Zsuzsanna  
*[Handwritten signature]*

NAGY ZSUZSANNA  
NAGY ZSUZSANNA

*[Handwritten signature]*

